

Prot. Nr. 10372

Datë 30.11.23

Prot. Nr. 301

Datë 30.11.2023,

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë, 30 . 11 .2023, midis palëve :

1. **“SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR”**, me adresë : Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, me NIPT: **J72216003P** Përfaqësuar nga **Zj.REME XHOLI**, në cilësinë e Drejtorit të Pergjithshem;  
Dhe
2. **SHOQATA “MIRËSI PËR BOTËN”**, Organizatë Jofitimprurëse, regjistruar me Vendim Gjykatë Nr. **6594**, datë **10/12/2020**, me adresë: Lagja “Hekurudha”, Elbasan, me NIPT: **M03622337I** përfaqësuar nga **Z. MOHUMMED UMAR HANIF SAYED**, në cilësinë e Kryetarit të saj.

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i Marrëveshjes është bashkëpunimi i ndërsjelltë për ofrimin e Suportit nga ana e Shoqatës **“MIRËSI PËR BOTËN”**, me fokus kryesor në mbështetje të fëmijëve me mungesë të kujdesit prindëror, dhe shtresa e kategori të tjera shoqërore në nevojë.

Dispozitat e kësaj marrëveshje do të interpretohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 2 Objekti i Marrëveshjes**

1. Palët bien dakord për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim forcimin e bashkëpunimit për mbështetjen e familjeve në nevojë.
2. Palët bien dakort të bashkëpunojnë në projekte dhe nisma të përbashkëta që kontribuojnë kryesisht në përmirësimin e kushteve të jetës të fëmijëve me mungesë të kujdesit prindëror, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve që rriten në familje me probleme social-ekonomike dhe familjeve në nevojë.

#### **Neni 3 Marrëveshje shtesë**

Në vijim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe brenda , Institucionet e varësisë mund të aplikojnë për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta shtesë, me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të vullnetit të palëve.





#### Neni 4 Konfidencialiteti

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do t'i komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
3. Çdo Palë, nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe /ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe/ose Donatorin përkatës.

#### Neni 5 Kohëzgjatja dhe disponueshmëria

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë 1 vjeçare, me të drejtë rinovimi.
2. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar më shkrim 1 (një) muaj përpara palën tjetër.

#### Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkeljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila Palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë organeve kompetente.

#### Neni 7 Dispozitat e fundit

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 5 të saj;
2. Marrëveshja mund të ndryshohet apo rinovohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga secila palë;
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Ajo hartohet në 4 kopje të barazvlefshme, nga dy kopje për secilën palë.

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Reme XHOLI  
DREJTOR I PËRÇKËTIMIT



SHOQATA "MIRËSI PËR BOTËN"

Mohammed Umar Hanif SAYED  
KRYETAR I SHOQATËS

